



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE
“HEKURUDHAT E KOSOVËS” - TRAINKOS SH.A
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos sh.a në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Arvita Zyferi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi dhe anëtarja e ekipit Valbona Pllana, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Qeverisja e mirë.....	29
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	30
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	35
Shtojca II: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit	38

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës – Trainkos sh.a (më tutje Trainkos) për vitin 2018, i cili e përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09/01/2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Trainkos-it.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018, përveç efekteve të përshkruara në paragrafin Bazën për Opinion të kualifikuar, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Keqdeklarimet materiale të cilat janë të përhapura në tërë pasqyrat financiare kanë ndikuar në modifikimin e opinionit për PFV-të e vitit 2018.



Kryesuesi i Bordit duhet t'i analizojë arsyet për modifikim të opinionit për PFV-të e vitit 2018 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të PFV-ve në vitin 2019.

(shih çështjet të baza për opinon 2.1).

Mungesa e kontrolleve adekuate në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit ka rezultuar me gabime financiare gjatë procedimit të pagesave dhe regjistrimit të zërave në kontabilitet.



Kryesuesi i Bordit duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të çështjeve theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive, dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato.

(shih çështjet e prezantuara të kapitulli i MFK-së).

Kontrollet jo adekuate në fushën e të hyrave kanë rezultuar me zhvillimin e aktiviteteve të cilat janë jashtë fushëveprimit të Trainkos-it.



Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se aktivitetet e Ndërmarrjes janë të ndërlidhura me fushëveprimtarinë e saj, të paraparë me statut dhe me plan të biznesit.

(shih çështjen A12).

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me të gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ndërmarrjes Publike Trainkos sh.a gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase;
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Trainkos-it, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (më tutje AP-së).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit si dhe janë dhënë rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (më tutje PFV-ve) merr parasysht pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Përfshirë deklaratën e bërë të përgatitur dhe nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) të cilat janë dorëzuar për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i kualifikuar

Kemi audituar PFV-të e Trainkos-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese. Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të Trainkos për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kualifikim

Ne kemi krijuar bazën për opinion të kualifikuar, për arsyt e përmendura në vijim:

- Sipas SNK 7, pasqyra e rrjedhës së parasë raporton rrjedhën e mjeteve monetare gjatë periudhës duke i klasifikuar në aktivitete operative, investuese dhe financuese. Trainkos ka pranuar mjete për investime kapitale nga MZHE (aksionari) 260,353€ të cilat nuk i ka prezantuar fare në aktivitetin financues të rrjedhës së parasë;
- Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera në PVF-të e vitit 2018 ishin 2,312,618€. Për të testuar saktësinë e tyre ne kemi kërkuar nga Trainkos ti dërgojë 7 letër konfirmime te

klientët e Ndërmarrjes, për të konfirmuar vlerën e borxheve të tyre ndaj Trainkosit. Sipas regjistrimit kontabël totali i këtyre llogarive të arkëtueshme që kërkuam konfirmimet ishte 1,783,664€, prej tyre ne pranuar pesë (5) letër konfirmime në shumë prej 1,247,117€. Dy prej tyre ishin të mbivlerësuar në regjistrin kontabël, njëra për 4,343€ dhe tjetra për 8,699€. Në njërin nga konfirmimet e papranuara klienti ishte në proces gjyqësor për 152,978€ dhe për rastin tjetër në vlerë 370,526€ nuk kemi pranuar konfirmimin. Këto diferenca kanë rrjedhur për shkak se nuk janë bërë harmonizime periodike në mes Trainkos-it dhe klientëve të saj;

- Sipas SNK 16, kërkohet që njëherë në 3 deri 5 vite të bëhet rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese. Vlera e pasurive jo qarkulluese (prona, pajisjet & impiantet) ishte 5,489,323€. Trainkos nuk ka bërë rivlerësimin e tyre që nga viti 2007. Andaj ne nuk ishim në gjendje të konstatojmë nëse kjo vlerë është e saktë, apo e mbi/nënvlerësuar. Kjo (sipas Trainkos) nuk ishte bërë në mungesë të fondeve për të financuar një kompani të licencuar për rivlerësimin e pasurive; dhe
- Shënimet shpjeguese nuk japin informacione dhe shifra të sakta, për disa nga zërat e prezantuar në pasqyrën e pozitës financiare dhe atë të ardhurave dhe shpenzimeve. Për më shumë detaje shih nënkaptullin 3.6.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Ndërmarrjeve Publike (më tutje NP) në Kosovë, ZKA është e pavarur nga Trainkos dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Menaxhmenti i Trainkos-it është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit akreal sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L- 42 për Prokurimin Publik (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përmbushin edhe kërkesat në vijim:

- Statutin e NP-së;
- Planin e Biznesit;
- Raportet tremujore;
- Raportin vjetor;
- Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
- Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, deklarata e bërë nga KE dhe ZKFTH me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtorëve, mund të konsiderohet e saktë. Përveç çështjeve të lartpërmendura, PFV-të paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se zërat përbërës të pasqyrës së rrjedhës së parasë janë prezantuar drejtë nëpër aktivitetet përkatëse operative, investuese dhe financuese dhe janë dhënë sqarimet e nevojshme në shënimet shpjeguese të PFV-ve.

Rekomandimi A2 Kryesuesi i bordit duhet të siguroi se janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme të komunikimit dhe bashkëpunimit me klientët borxhli, në mënyrë që të sigurohen me kohë konfirmimet ndaj auditorit lidhur me vlerën e detyrimeve ndaj Trainkos-it.

Rekomandimi B1 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer rivlerësimin e pasurive fikse dhe kjo të bëhet së paku njëherë në pesë (5) vite për ta vërtetuar vlerën e saktë të pasurive në përputhje me SNK 16.

Rekomandimi C1 ¹ Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kualifikuar dhe do të merren veprimet e nevojshme për eliminimin e tyre. Gjithashtu, kryesuesi i bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që procesi i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.

¹ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Ndërmarrjen Publike Trainkos. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së ndërmarrjes që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i Trainkos-it të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare por edhe për të siguruar që këto vendime janë adekuate dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmes përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë. Dobësitë e identifikuara në fushën e shpenzimeve kanë të bëjnë me regjistrimin e shpenzimeve jo në përputhje me parimin aktual, pranimin e faturave me informata jo të sakta, humbjen e naftës për shkak të pajisjeve të vjetra apo kujdesit jo të duhur nga personeli, procedurave të prokurimit të shpeshta me vlera minimale për artikuj të njëjtë si dhe mungesën e një rregulloreje për provizione.

3.1 Plani i biznesit (të hyrat dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2018 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Të hyrat nga transporti i mallrave	1,205,323	720,332	561,178	842,835
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve	249,500	149,700	98,967	125,387
Të hyrat nga subvencionet - MZHE	500,000	500,000	500,000	744,814
Të hyrat nga subvencionet - MI	1,967,292	1,316,000	1,170,612	1,151,613
Të hyrat nga grantet për investime kapitale - MZHE	1,000,000	800,000	260,353	891,480
Të hyrat tjera ²	140,000	140,000	128,352	385,839
Gjithsej të hyrat	5,062,115	3,626,032	2,719,462	4,141,968

² Të hyrat tjera të planifikuara prezantojnë: të hyrat nga dëmtimi i vagonëve 40,000€, të hyrat tjera jo operative 50,000€, dhe të hyrat nga shërbimet tjera 50,000€.

Shpenzimet për paga	1,810,000	1,705,000	1,696,783	1,674,841
Mallra dhe Shërbime	453,115	260,000	214,296	272,946
Kosto e shërbimit	1,740,000	860,000	962,185	1,151,853
Investimet kapitale	1,000,000	800,000	260,354	964,095
Gjithsej shpenzimet	5,03,115	3,625,000	3,133,618	4,063,735

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Të hyrat nga transporti i mallrave me plan fillestar ishin paraparë 1,205,323€, derisa me rishikim të planit të biznesit janë zvogëluar për 484,991€ apo 40%. Kjo ka ndodhur për shkak se klienti kryesor (operator ekonomik) i Trainkos-it, nuk ka punuar për pesë (5) muajt e parë të vitit si rezultat i ndërrimit të aksionarit. Po ashtu hyrja në treg e një operatori privat në transportin e mallrave ka ndikuar në rënien e të hyrave nga kjo kategori;
- Të hyrat nga transporti i udhëtareve të parapara me plan të biznesit ishin zvogëluar me rishikim të planit të biznesit për 99,800€ apo 40%. Po ashtu edhe realizimi i të hyrave është më i ulët në raport me planifikimin përfundimtar për 50, 733€. Rënia e të hyrave nga udhëtarët është rezultat i rënies së vazhdueshme të frekuencës së përdorimit të trenave nga udhëtarët;
- Me rishikim të planit të biznesit kategoria për mallra dhe shërbime ishte zvogëluar për 193,115€ apo 43% si rezultat i mos vlerësimit të saktë të shpenzimeve për pajisje dhe mobile. Po ashtu edhe zvogëlimi i të hyrave ka ndikuar në reduktimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime;
- Kostot e shërbimit me plan të biznesit të rishikuar janë zvogëluar për 880,000€ apo 51%, për shkak se zvogëlimi i transportit të mallrave ka pasur ndikim direkt edhe në koston e shërbimeve; dhe
- Investimet kapitale sipas planit fillestar ishin paraparë 1,000,000€, deri sa me rishikim të këtij plani janë zvogëluar në 800,000€. Përveç kësaj, 539,646€ nuk janë alokuar nga MZHE për shkak se një projekt kapital i planifikuar shumë vjeçar "Blerja e një treni motorik" ndonëse i buxhetuar si projekt, ka dështuar procesi i ri-tenderimit për katër herë me radhë. Dështimi në këtë projekt ka ndodhur për shkak të mungesës së ofertuesve.

Çështja A3 - Planifikimi dhe realizimi jo i duhur i planit të biznesit

Gjetja Qëllimi i planit të biznesit në përgjithësi është arritja e synimeve të kompanisë sipas prioriteteve të saj. Sipas analizave të buxhetit, realizimi i të hyrave në raport me planin e rishikuar të biznesit ishte rreth 75%, ndërsa realizimi i të hyrave nga transporti i udhëtarëve dhe i të hyrave nga grantet për investime kapitale ishin 66% dhe 33% respektivisht. Sa i përket shpenzimeve, realizimi i planit për investime kapitale ishte në nivelin 32%, ndërsa buxheti për kostot e shërbimit në raport me planin përfundimtar ishte tejkaluar. Kjo ka ndodhur në mungesë të një analize të saktë lidhur me aftësinë e kompanisë për gjenerimin e të hyrave si dhe për shkak të analizave jo adekuate për realizimin e projekteve kapitale.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët, sidomos për të hyrat dhe investimet kapitale, mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të kompanisë. Ndërsa mungesa e informatave lidhur me burimet e financimit mund të rezultojë me mos realizim të projekteve.

Rekomandimi A3 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e rishikimit të planit të biznesit, bëhen analiza më të sakta lidhur me gjenerimin e të hyrave nëpër secilën kategori. Po ashtu, të bëhet një analizë e detajuar aktivitetëve investuese të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas planit.

3.2 Pasqyra e pozitës financiare

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrës së pozitës financiare, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare e Trainkos-it më 31 dhjetor 2018 (në €)

Pasuritë	Viti 2018	Viti 2017
Toka	0	0
Prona, pajisjet dhe impiantet	5,489,323	6,108,772
Investime në vijim	10,432	0
Pasurit e paprekshme	122	1,562
Stoqet	429,170	455,752
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	2,312,618	1,711,928
Pasuritë tjera afatshkurta (parapagimet e dhëna)	24,793	270,654
Paraja në bankë dhe arkë	54,938	695,291
Gjithsej Pasuritë	8,321,396	9,243,959

Ekuiteti		
Kapitali themelor	25,000	25,000
Kapitali rezerve	5,282,692	5,332,262
Fitimet/Humbjet e mbajtura	(1,595,840)	(1,102,387)
Fitimet/Humbjet e vitit	(476,289)	(493,453)
Rezervat tjera	2,262	28,079
Detyrimet		
Detyrimet afatgjata	3,186,968	3,933,998
Llogaritë e pagueshme tregtare	1,896,603	1,520,460
Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti	8,321,396	9,243,959

Çështja B2 - Mos barazimi i gjendjes faktike të stoqeve me regjistrat kontabël

Gjetja

Regjistrat kontabël duhet të përmbajnë informata të plota dhe të sakta lidhur me gjendjen e pasurisë së NP-së. Ndërmarrja në fund të vitit kishte bërë numërimin e stoqeve dhe kishte përgatitur raportin e inventarizimit, mirëpo, ky raport nuk përputhet me evidencat kontabël. Në raportin e komisionit të inventarizimit ishte paraqitur vlera 424,499€, ndërsa në shënimet e kontabilitetit ishte prezantuar vlera 428,509€, pra me një mospërputhje në shumën prej 4,010€. Ndërmarrja kishte marrë disa veprime për barazimin e gjendjes së stoqeve sipas regjistrimit të komisionit me evidencat kontabël, mirëpo nuk kishte arritur ta përfundonte me sukses këtë proces.

Rreziku

Mungesa e një pasqyre të saktë të gjendjes së stoqeve rrit rrezikun që Ndërmarrja të bëjë furnizime të panevojshme apo të mos jetë në gjendje t'i bëjë furnizimet e duhura për shkak të informacioneve të mangëta kontabël. Për më tepër, kjo situatë rritë edhe rrezikun e keqpërdorimit të stoqeve nga personat përgjegjës.

Rekomandimi B2

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që bëhen barazimet e gjendjes së stoqeve në evidencat kontabël me gjendjen e tyre faktike si dhe të sigurojë se janë shtuar kontrollet për monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Po ashtu kurdo që paraqiten diferenca të tilla të vazhdohet me hulumtimin e tyre deri të identifikohen diferenca dhe shkaktarët.

Çështja A4 - Mos reflektimi i korrigjimit edhe tek periudha paraprake e pasqyrës

- Gjetja** Sipas SNK 8, kërkohet që ndryshimet kontabël dhe korrigjimet e gabimeve të periudhave paraardhëse të kontabilizohen retrospektivisht. Në pasqyrën e pozitës financiare kapitali rezervë në fund të vitit ishte prezantuar në shumë prej 5,282,692€, apo 49,570€ më pak se vlera në fillim të vitit. Një pjesë e këtij ndryshimi është pasojë e një gabimi ku pjesët rezervë ishin regjistruar me çmim 25,031€ ndërsa çmimi i tyre ishte 250.31€. Gabimi është konstatuar nga komisioni për inventarizim dhe regjistrim të stokeve në fund të vitit 2018. Komisioni ka vërtetuar se gabimi është bartur nga vitit paraprak dhe rregullimet janë bërë vetëm në vitin aktual, por duke mos i prezantuar edhe në periudhën paraardhëse (saldon) e këtij zëri. Lidhur me përmbajtjen e pjesës tjetër të shumës që e ka zvogëluar kapitalin rezervë nuk kemi gjetur dëshmi apo arsyetim nga ndërmarrja. Po ashtu, për këto ndryshime nuk ishin shpalosur arsyet dhe efektet e korrigjimit në pasqyrën e shënimeve shpjeguese.
- Rreziku** Reflektimi i korrigjimit të gabimeve paraprake vetëm në kolonën e vitit raportues dhe jo edhe në kolonën e vitit paraardhës në PVF, krijonë paqartësi dhe gabime për analiza të trendëve tek zëri i korrigjuar.
- Rekomandimi A4** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që korrigjimet e efekteve nga periudhat paraprake të reflektohen edhe në kolonën e vitit paraardhës e jo vetëm në atë të vitit raportues. Gjithashtu të shpalosen në shënimet shpjeguese të pasqyrave arsyet dhe efektet e korrigjimit për secilin zë të pasqyrave.

Çështja B3 – Parapagimet e dhëna në vitin 2014 për shërbimet të cilat ende nuk janë pranuar

Gjetja Sipas SNK 1 shpenzimet e parapaguara shfaqen atëherë kur paguhet paraja para se të merret shërbimi apo të përdoret artikulli, ndërsa shpenzimet njihen gjatë periudhës kur ato ndodhin si pasojë e pranimi të mallit ose shërbimit. Sipas të dhënave të lartshënuara, në pasqyrën e pozitës financiare të Trainkos-it janë regjistruar si parapagime shuma në vlerë prej 24,793€ të bartura nga viti 2014. Në bazë të rishikimit të transaksioneve kjo shumë prezanton disa parapagime (avance) ndaj klientëve të ndryshëm për të cilët nuk ka dokumentacion apo informata të mjaftueshme. Sipas zyrtareve financiar, kjo shumë është bartur vite me radhë dhe pasqyron avance të dhëna për shërbime, për të cilat ndërmarrja ende nuk ka arritur të përfitoj deri në fund të vitit 2018.

Rreziku Mungesa e qartësisë të situatës lidhur me pronësinë e llogarisë së parapagimeve dhe bartja e saj ndër vite pa mbulesë me dokumentacionin përkatës paraqet rrezik që shërbimet e parapaguara të mos realizohen dhe kjo vlerë të bartet ndër vite në PF pa ndonjë efekt financiar.

Rekomandimi B3 Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprime adekuate për qartësimin e situatës në mes të dy kompanive dhe të siguroj dokumentacionin e nevojshëm që mbështet vlerën e parapagimeve në mënyrë që të realizoj këtë vlerë përmes marrjes së mallit apo shërbimit për to.

Çështja A5 – Mungesa e politikave për provizionimin e borxheve të këqija

Gjetja Objektivi i SNK 37 është të sigurojë se janë zbatuar kriteret e duhura të njohjes dhe bazat e matjes për provizionet, pasivet dhe aktivet e kushtëzuara. Ndërmarrja nuk ka pasur një politikë adekuate të njohjes së provizioneve për borxhet e këqija dhe të dyshimta. Ajo ka regjistruar dhe prezantuar si shpenzime të borxheve të këqija shumën prej 24,798€, pa pasur ndonjë analizë të vjetërisë dhe pa pasur rregullore për provizionet e borxheve të këqija. Kjo ka ndodhur pasi bordi i drejtoreshave nuk ka marrë hapa konkret për hartimin e një Rregulloreje të tillë.

Rreziku Mungesa e një rregulloreje për provizione si dhe mungesa e një analize për vjetërsinë dhe vlerësimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta mund të ketë ndikim në rritjen e rrezikut për menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, dhe marrjen e vendimeve të gabuara lidhur me to.

Rekomandimi A5 Kryesuesi i Bordit duhet të marrë veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Ndërmarrja publike Trainkos në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2018 (në €)

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	3,460,398	4,164,607
Gjithsej të Hyrat	3,460,398	4,164,607
Shpenzimet për paga	(1,696,784)	(1,674,842)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(1,032,000)	(943,305)
Shpenzimet tjera	(1,183,106)	(1,516,681)
Shpenzimet për borxhe të këqija	(24,798)	(523,232)
Gjithsej Shpenzimet	(3,936,688)	(4,658,060)
Fitimi/Humbja para tatimit	(476,290)	(493,453)
Tatimi në fitim	0	0
Fitimi/Humbja neto	(476,290)	(493,453)

Çështja A6 - Plani për menaxhim të kontratës jo sipas formës standarde

Gjetja Sipas nenit 81 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), autoritetet kontraktuese janë të obliguara të përgatisin planin për menaxhimin e kontratës. Plani i Menaxhimit të Kontratës (PMK) është dokument i cili do të përditësohet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plani i Menaxhimit të Kontratës është dokument i hapur për monitorim nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) gjatë implementimit të kontratës. Në tri (3) projekte, PMK nuk ishte plotësuar nga mbikëqyrësi i projektit sipas formës standarde. Rastet e tilla janë si në vijim:

- Projekti “Renovimi i objektit të tërheqjes së trenave”;
- Projekti “Furnizim me vagonë të përdorur të udhëtareve me riparim të mesëm; dhe
- Projektit “Furnizimi dhe montimi i vinçave dhe mjeteve tjera”.

Sipas zyrtarit të prokurimit, ndërmarrja ka pasur të kontraktuar organin mbikëqyrës dhe duke pasur parasysh rregullat e ndërtimit janë pajtuar që firma mbikëqyrëse të mbaj ditarët e punës dhe raportin të cilin e përdor ajo. Po ashtu, Trainkos-i kishte përdorur një formë tjetër të raportimit të adaptuar për nevojat e veta.

Rreziku Mos përgatitja e planit për menaxhimin e kontratës sipas kërkesave të LPP-së, është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe mund të rrezikojë që të mos përfshihen të gjitha informatat relevante që i kërkon forma standarde.

Rekomandimi A6 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se menaxheri i kontratës përgatit formën standarde të menaxhimit të secilit projekt me qëllim të raportimit të saktë të situacioneve të kryera dhe lehtësimit të monitorimit nga organet kompetente dhe palët e interesit.

Çështja A7 - Prokurime të shpeshta me vlera minimale

- Gjetja** Sipas rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit publik, autoriteti kontraktues mund ta përdor procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlera e përlogaritur e të cilës është më pak se 1,000€. Me dhënien e porosive për blerje në lidhje me prokurimin me vlerë minimale, Autoriteti kontraktues do të sigurojë një konkurrim efektiv, transparencë dhe efektivitet të lartë të përdorimit të fondeve publike. Në bazë të rishikimit të listës së prokurimeve/kontratave të realizuara, Trainkos ka realizuar gjithsej 95 kontrata të ndryshme gjatë vitit 2018, ku 49 prej tyre janë me vlera minimale nën 1,000€. Në bazë të testimit të 10 mostrave kemi gjetur se në katër (4) raste ishin zhvilluar procedura të prokurimit duke zbatuar kontrata me vlerë minimale për projektin e njëjtë "Furnizim me ujë të pijshëm" si dhe në tre (3) raste kemi gjetur se janë furnizuar me bateri me vlerë minimale nën 1,000€. Ndarja e kërkesave ka rrjedhur si rezultat i mos identifikimit të nevojave për furnizime me kohë dhe mos planifikimit të duhur të sasisë për këto furnizime.
- Rreziku** Aplikimi i procedurave me vlerë minimale për artikujt e njëjtë mund të rezultojë me kosto më të lartë krahasuar me aplikimin e procedura tjera të zhvilluara në konkurrencë të hapur.
- Rekomandimi A7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se bëhet identifikimi i nevojave për furnizime nga të gjitha njësitë kërkuese dhe njëjtat përfshihen në planin vjetor të prokurimit. Përgatitja adekuate e planeve për furnizime ndihmon në zhvillimin e procedurave adekuate dhe shtim të vlerës për para.

Çështja A8 - Regjistrimi i shpenzimeve të sigurimit të automjeteve jo sipas parimit akrual

Gjetja Sipas parimit akrual të kontabilitetit efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike tjera duhet të njihen në momentin e ndodhjes (jo atëherë kur paraja apo ekuivalentet e saj merren apo paguhen) dhe ato duhet të regjistrohen në regjistrat e kontabilitetit dhe raportohen në pasqyrat financiare në periudhën të cilës i takojnë. Sipas regjistrave kontabël të Trainkos-it, shuma në vlerë prej 1,735€ e paguar për sigurimin e automjeteve, është regjistruar si shpenzim i periudhës përderisa do të duhej të regjistrohej si parapagim në fillim të vitit dhe pastaj në fund të vitit të bëhen rregullimet e nevojshme. Regjistrimi i gabuar i pagesës për sigurimin e automjeteve ka ndodhur për shkak të interpretimit jo të drejtë të SNK 1, si dhe për shkak se zëri i parapagimit nuk është përfshirë në planin kontabël të cilin e posedojnë.

Rreziku Regjistrimi i parapagimeve si shpenzime të periudhës ndikon në nënvlerësimin e pasurive në pasqyrën e pozitës financiare dhe në mbivlerësimin e shpenzimeve në pasqyrën e të ardhurave.

Rekomandimi A8 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që zyra e financave regjistrojnë transaksionet në mënyrë të drejtë duke interpretuar drejtë standardet e kontabilitetit. Po ashtu duhet të sigurojë që plani kontabël përmban të gjithë zërat që mbulojnë transaksionet e Kompanisë në përputhje me kërkesat e SNK-ve.

Çështja A9 - Regjistrimi i gabuar i Tatimit të Vlerës së Shtuar (TVSH) në blerje

- Gjetja** Sipas detyrave dhe përgjegjësive, zyrtari certifikues siguron se janë plotësuar kushtet e kontratës para se të bëhet pagesa, dhe që kërkesa për pagesë është e koduar në zërin e duhur të shpenzimeve si dhe fatura është e rregullt. Gjatë testimit të 33 mostrave kemi vërejtur se, dy (2) prej tyre kanë rezultuar me gabime, njëra në shumë prej 640€ dhe tjera në shumë 450€, të cilat janë paguar në emër të pastrimit të rezervarëve të ujërave të zeza në vagona dhe të pusetave. Pagesa totale prej 1,090€ ishte bërë me TVSH të llogaritur nga operatori prej 8% deri sa do duhej të llogaritej me 18%. Sipas faturës së operatorit, TVSH-ja për dy pagesat prej 8% ishte rreth 81€, mirëpo kjo vlerë ishte nënvlerësuar për 85€. Faturat janë pranuar duke mos u verifikuar vlera e TVSH-së dhe kjo ka ndodhur si pasojë e pakujdesisë së zyrtarëve për pranim të faturës dhe si e tillë me gabim është regjistruar në kontabilitet.
- Rreziku** Mos rishikimi i faturave të pranuar duke mos verifikuar llogaritjen e TVSH-së, rezulton me gabim financiar dhe deklarim të gabuar për TVSH-në e arkëtueshme.
- Rekomandimi A9** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se çdo faturë kontrollohet me kujdesin e duhur nga zyrtarët përgjegjës para se të procedohet më tutje në kontabilitet, ndërsa për rastet e identifikuara me gabime të kërkojnë që të bëhen korrigjimet e nevojshme për t'i eliminuar efektet e gabimit.

Çështja A10 – Regjistrimi i humbjes së naftës**Gjetja**

Proceduat e pranimit të naftës bëhen nga komisioni për pranimit të naftës dhe pas pranimit të mallit konstatohet nëse mallrat apo furnizimet janë në përputhje me dokumentet përcjellëse si fletë-dërgesa apo fatura e furnizuesit. Me rishikimin e listës së ofruar për 12 muaj të vitit 2018 kemi vërejtur se furnizimi sipas furnizuesit ishte 637,962 litra (volum metrit) deri sa sipas mjetit matës (shipkë) nga Trainko-si sasia ishte 634,306 litra naftë. Sipas kësaj rrjedh se Trainkos ka një diferencë prej 3,656 litra me pak nga matja me mjetin matës (shipkë e shkallëzuar në milimetra). Në regjistrat kontabël me 31.12.2018 janë regjistruar në kontabilitet dy humbje sipas matjës me mjetin matës në sasi prej 3,656 litra apo 2,888€ dhe humbja e dytë në bazë të komisionit ishte në sasi prej 6,950 litra apo 5,490€. Shuma totale e humbjes sipas regjistrat kontabël në fund të vitit ishte 10,606 litra apo 8,378€. Kryeshefi Ekzekutiv me datën 22.11.2018 ka nxjerr vendim për formimin e komisionit në përbërje prej pesë (5) anëtarësh lidhur me hetimin e mungesës së naftës në depo. Sipas vlerësimit dhe konstatimit të komisionit defektet ishin te pajisjet e Trainkos-it, pasi që pajisjet e matjes së naftës nuk kanë bërë regjistrimin në mënyrë të saktë, nga se është vërejtur se furnizimi me naftë nga pompa bëhet duke regjistruar më pak furnizim. Departamenti i administratës kishte pohuar se vëzhgimi me kamera në depo të naftës nuk ka funksionuar në kohën e konstatimit të mungesës dhe kjo humbje ka mbetur si e pazbuluar. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të duhura ndaj furnizimeve, stokut dhe shpenzimeve të naftës.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve adekuate në pranimin e naftës duke përdorur mjete të pasigurta dhe duke mos u siguruar lidhur me funksionimin e kamerave gjatë kohës së verifikimit të sasisë së pranuar, paraqet rrezik që Kompania të dëmtohet financiarisht duke paguar për mallin të cilin nuk e ka pranuar.

Rekomandimi A10 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroi së janë marrë masat e nevojshme që mjetet e matjes së naftës të jenë të kalibruara dhe bëjnë matje të saktë, si dhe vëzhgimi i kamerave të jetë funksional gjatë gjithë kohës. Gjithashtu në periudha më të shpeshta të bëhen matjet e sasive në rezervar të naftës dhe të bëhet harmonizimi i shënimeve të kontabilitetit me gjendjen reale në mënyrë që të identifikohen dhe eliminohen me kohë humbjet e mundshme.

Çështja A11 - Ofrimi i shërbimeve (shitja e naftës) jashtë fushëveprimit dhe aktiviteteve të Ndërmarrjes

Gjetja Trainkos, sipas statutit të saj, fushëveprim kryesor ka menaxhimin, operimin dhe ofrimin e shërbimeve të transportit për udhëtarë, transportin e mallrave, ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtës dhe renovimit të të gjitha mjeteve lëvizëse për institucionet tjera jashtë hekurudhës. Trainkos-i gjatë vitit 2018, ka realizuar të hyra tjera duke shitur i naftë ndërmarrjes publike Infrakos sh.a në shumë prej 51,324€ (përfshirë 18%tvsh). Po ashtu plani i biznesit të cilin e ka miratuar bordi i drejtoreve nuk parasheh të hyra nga shitja e naftës. Shitja e naftës është bërë në bazë të marrëveshjes për shërbimet e përbashkëta e cila daton nga viti 2015.

Rreziku Shitja e naftës nga Trainkosi është në kundërshtim me statutin e ndërmarrjes. Prandaj, marrë parasysh edhe humbjet e naftës, ekziston një rrezik potencial për menaxhim jo të mirë të shitjes së naftës dhe krijim të të ardhurave jo të ligjshme.

Rekomandimi A11 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të marr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së naftës ndaj kompanisë tjetër deri sa kjo nuk është e përfshirë në fushë veprimtarinë e Trainkos-it.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të ndërmarrjes, ekuiteti është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Ekuiteti i Trainkos-it më 31.12.2018

(në €)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Ekuiteti	3,237,825	3,789,501
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	5,282,692	5,332,262
Fitimet/Humbjet e bartura	(1,595,840)	(1,102,387)
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(476,289)	(493,452)
Rezerva tjera	2,262	28,078

Çështja A12 – Mungesa e shënimeve shpjeguese për zvogëlimin e rezervave tjera

Gjetja Në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet është prezantuar zëri i rezervave tjera në shumë 2,262€, deri sa në fillim të vitit ishte 28,079€, pra ishte reduktuar për 25,817€. Ne nuk kemi marrë ndonjë sqarim me shkrim apo në formë verbale për këtë ndryshim. Prandaj, është vështirë të konstatohet se ky ndryshim është i prezantuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare. Po ashtu në shënimet shpjeguese nuk ka sqarime lidhur me zvogëlimin e kësaj llogarie.

Rreziku Mungesa e shënimeve shpjeguese lidhur me ndryshimin e shifrave të prezantuara në formë numerike në pasqyrat financiare paraqet mungesë të transparencës dhe sqarimeve adekuate për zërat përkatës.

Rekomandimi A12 Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj se ndryshimi i zërave të prezantuar në pasqyrën e ekuitetit referencohen dhe jepen sqarimet e nevojshme në shënimet shpjeguese për çdo ndryshim rreth tyre.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve operative, investuese dhe ato financuese. Informatat rreth rrjedhës së parave të ndërmarrjes janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme**(në €)**

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi/(humbja) vitit	(476,289)	(493,453)
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	0	0
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	0	0
Amortizimi i pasurive të paprekshme	0	0
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	0	0
Te ardhurat financiare	0	0
Shpenzimet financiare	0	0
Rritje/Zvogëlimi në llogarit e arkëtueshmeve	(600,690)	97,556
Rritje/Zvogëlimi në stoke	26,582	78,446
Rritje/Zvogëlimi në pasurit tjera	245,861	451,375
Rritje/Zvogëlimi në llogarit e pagueshmeve	376,143	660,336
Rritje/Zvogëlimi në detyrimet tjera	(747,030)	(31,553)
Rrjedha neto nga aktivitetet operative	(1,175,423)	762,707

<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investues</i>		
Arkëtimet nga shitja e pronës, pajisjeve dhe impianteve	610,457	(316,328)
Pagesat për blerjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve	0	0
Rrjedha neto nga aktivitetet investuese	610,457	(316,328)
<i>Rrjedha e parasë nga aktiviteti financues</i>		
Paratë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë	(49,569)	169,788
Dividendë e paguar	0	0
Pagesat tjera financuese	(25,818)	28,079
Rrjedha neto nga aktivitetet financuese	(75,387)	197,867
Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit	(640,353)	644,246
Paraja në fillim të vitit	695,291	51,045
Paraja në fund të vitit	54,938	695,291

Mangësitë lidhur me prezantimin e rrjedhës së parasë janë prezantuar tek baza për opinion.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja A13 - Shpalosje të mangëta në pasqyrën e shënimeve shpjeguese

Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë i pasqyrave financiare duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Gjatë analizimit të shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Në pasqyrën e shënimeve shpjeguese 'pasuritë e paprekshme' janë prezantuar me vlerë 5,489,444€, ndërsa në pasqyrën e pozitës financiare këtij zëri i referohen me emërtimin "prona, pajisjet dhe impiantet" dhe vlera e tij është 5,489,323€, pra me një diferencë 121€. Për më tepër, numrat e referencave në pasqyrën e pozitës financiare dhe në shpalosje nuk përputhen pasi që referenca me nr. 4 në pasqyrën e pozitës financiare i referohet llogarive të arkëtueshme ndërsa te shpalosjet referenca nr.4 mbulon pasuritë e paprekshme.
- Në shënimet shpjeguese llogaritë e arkëtueshme janë referencuar me nr. 6 dhe me vlerë 2,337,411€ ndërsa në pasqyrën e pozitës financiare janë referencuar me nr. 4 dhe me vlerë 2,312,618€ pra me një diferencë 24,798€;
- Në shënimet shpjeguese referenca nr. 7 shpalosë paratë në bankë dhe arkë, ndërsa në pasqyrën e pozitës financiare ky zë është referencuar me nr.3;
- Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, të hyrat janë prezantuar në shumë 3,460,398€ dhe me referencë nr. 14, ndërsa në shënimet shpjeguese të hyrat në shumë 3,466,635€, janë shpalosur tek referenca nr. 11, dhe në mes këtyre dy vlerave ekziston një diferencë prej 6,238€;
- Në shënimet shpjeguese referenca nr. 12 jep sqarime për shpenzimet, ndërsa në pasqyrën e pozitës financiare shpenzimet janë prezantuar me referencën nr.3;
- Në shënimet shpjeguese nuk është dhënë asnjë sqarim për zvogëlimin e kapitalit;
- Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë prezantuar shpenzime tjera në vlerë 1,183,106€ dhe janë referencuar me nr. 16, ndërsa në shënimet shpjeguese nuk ishte shpalosur asnjë sqarim lidhur me këto shpenzime.
- Në pasqyrën e pozitës financiare kapitali aksionar dhe rezervat tjera, janë referencuar me nr.19, ndërsa në shënimet shpjeguese nuk ka referencë me këtë numër.

Mangësitë e evidentuara në pasqyrën e rrjedhës së parasë janë rezultat i mos rishikimit me kujdes i pasqyrave financiare nga menaxhmenti para se të përcillen për aprovim nga bordi i drejtorëve.

Rreziku Mos prezantimin i saktë i referencave, emërtimeve të zërave dhe shumave në shënimet shpjeguese me ato të pasqyrave tjera paraqesin prezantim jo të plotë të zërave sipas SNK-ve dhe paqartësi tek përdoruesit e jashtëm të pasqyrave financiare dhe te aksionari.

Rekomandimi A13 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit. Për më tepër, ato nuk duhet të miratohen pa një rishikim të hollësishëm të të gjithë zërave të pasqyrave financiare si dhe pa plotësinë dhe saktësinë e shënimeve shpjeguese.

4 Qeverisja e mirë

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja, vështruar në kuptimin e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe planifikimit strategjik, pasqyron një situatë pozitive. Trainkos ka shënuar progres të vazhdueshëm në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga vitet paraprake, përfshirë raportimin menaxherial dhe llogaridhënien. Përkundër progresit të arritur për një qeverisje edhe më të mirë menaxhmenti duhet t'i kushtoj kujdes të duhur funksionalizimit të NJAB, dhe kontrollit lidhur me çështjet e ngritura në këtë raport.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka qenë jo funksionale gjatë tërë vitit 2018, pasi që përzgjedhja e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm edhe pse ishte bërë me 30.11.2018, i njëjti kishte filluar me punë në janar të vitit 2019. Trainkos kishte zhvilluar procese të rekrutimit shtatë (7) herë gjatë kësaj periudhe (3 herë në vitin 2017 dhe katër (4) herë në vitin 2018), mirëpo nuk kishte arritur të bëjë përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm deri në procesin e rekrutimit në fund të vitit 2018. Punën e Zyrtarit auditues gjatë kësaj periudhe e kishte ushtruar pjesërisht një zyrtar, duke kryer auditime vetëm për projektet kapitale.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ndërmarrjen.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nevojiten aktivitete shtesë për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Trainkos-it ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tetë (8) rekomandime janë zbatuar, dy(2) ishin pjesërisht të zbatuara dhe tri (3) ishin të pa zbatuara ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

N r.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejte dhe të vërtetë të tyre.</p> <p>Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve të vitit 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.</p>	Menaxhmenti ka marrë veprim lidhur me korrigjimin e PFV të vitit 2017. Ato janë prezantuar ekipit të auditimit.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozitës financiare)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është hartuar një listë e saktë e pasurive jo qarkulluese dhe se janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar pasqyrat financiare si dhe të siguroj se me rastin e hartimit të tyre, burim të jenë evidencat kontabël.	Menaxhmenti ka ndërmarre hapa për përmirësime në prezantimin e pasurive, por ende nuk ka një regjistër të plotë.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

3	Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozitës financiare)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që bëhen barazimet e gjendjes së stoqeve në evidencat kontabël me gjendjen faktike të tyre si dhe të siguroj se janë shtuar kontrollet për përcjelljen e gjendjes së stoqeve dhe se po bëhen raportimet tek menaxhmenti në baza të rregullta periodike.	Menaxhmenti ka bërë disa të stoqet, por ende ka mos barazim në mes regjistrit kontabël dhe gjendjes faktike.	Rekomandim i pa zbatuar.
4	Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozitës financiare)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që me rastin e hartimit të PVF-ve zërat financiar të prezantojnë vlerë të saktë financiare. Po ashtu, të siguroj që në një afat sa më optimal për shumën e paguar si avancë janë realizuar shërbimet/ furnizimet në këmbim të kësaj shume.	Nuk janë ndërmarrë masa për përmirësim.	Rekomandim i pa zbatuar.
5	Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozitës financiare)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që në baza të rregullta mujore të vërtetohet plotësia dhe saktësia e listës së detyrimeve ndaj furnitorëve dhe se zyrtarët përkatës raportojnë tek menaxhmenti.	Menaxhmenti ka ndërmarrë hapa për korrigjimin e gabimeve të listës së furnitorëve.	Rekomandim i zbatuar.
6	Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozitës financiare)	Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme, që shënimet kontabël të jenë në harmoni me gjendjen e borxheve në ATK dhe që obligimet të paguhen sipas afateve të parapara. Njëkohësisht, duhet të siguroj prezantim të saktë të zërave financiar.	Menaxhmenti ka ndërmarrë hapa për prezantimin e detyrimeve ndaj ATK-së.	Rekomandim i zbatuar.
7	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se raportet e shitjeve dorëzohen me kohë dhe se njohja dhe raportimi i të hyrave për periudhën përkatëse bëhet në momentin e ndodhjes dhe jo kur pranohet paraja.	Menaxhmenti ka ndërmarrë hapa dhe ka korrigjuar raportimin e të hyrave.	Rekomandim i zbatuar.
8	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që bëhen korrigjimet e nevojshme dhe po ashtu, që shpenzimet të njihen në momentin që ndodhin, respektivisht në periudhën që janë shkaktuar.	Menaxhmenti ka ndërmarrë hapa dhe ka korrigjuar raportimin e shpenzimeve.	Rekomandim i zbatuar.
9	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë mangësitë e identifikuar dhe të marrë masat e nevojshme që angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike dhe hartimi i testit të bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.	Menaxhmenti ka ndërmarrë hapa për këtë rekomandim.	Rekomandim i zbatuar.
10	Trajtimi i shënimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet	Menaxhmenti nuk ka	Rekomandim i pa zbatuar.

	shpjeguese	shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	ndërmarrë hapa për këtë rekomandim.	
11	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është duke u monitoruar rregullisht dhe se po zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara kohore. Në fokus parësor duhet të jenë rekomandimet që kanë ndikim në opinion dhe që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.	Menaxhmenti ka hartuar planin e veprimit.	Rekomandim i zbatuar.
12	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj funksionimin e ndërmarrjes në mënyrë efektive dhe për këtë duhet ta përzgjedh zyrtarin e auditimit të brendshëm sipas kërkesave ligjore, për të ndihmuar menaxhmentin lidhur me vlerësimin e kontrolleve të brendshme në ndërmarrje.	Menaxhmenti ka ndërmarrë hapa dhe është përzgjedhur auditorja e brendshme në fund të vitit 2018.	Rekomandim i zbatuar.
13	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese për ndarje të duhur të detyrave për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese	Menaxhmenti ka caktuar një zyrtar të pasurisë.	Rekomandim i zbatuar.
	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se zërat përbërës të pasqyrës së rrjedhës së parasë janë prezantuar drejtë nëpër aktivitetet përkatëse operative, investuese dhe financuese dhe janë dhënë sqarimet e nevojshme në shënimet shpjeguese të PFV-ve.		
2	PFV	Kryesuesi i bordit duhet të siguroi se janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme të komunikimit dhe bashkëpunimit me klientët borxhli, në mënyrë që të sigurohen me kohë konfirmimet ndaj auditorit lidhur me vlerën e detyrimeve ndaj Trainkos-it.		
3	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer rivlerësimin e pasurive fikse dhe kjo të bëhet së paku njëherë në pesë (5) vite për ta vërtetuar vlerën e saktë të pasurive në përputhje me SNK 16.		
4	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kualifikuar dhe do të merren veprimet e nevojshme për eliminimin e tyre. Gjithashtu, kryesuesi i bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që		

		procesi i hartimit të PFV-ve për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.
5	Plani i biznesit	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e rishikimit të planit të biznesit, bëhen analiza më të sakta lidhur me gjenerimin e të hyrave nëpër secilën kategori. Poashtu të bëhet një analizë e detajuar aktiviteteve investuese të planifikuara për tu realizuar gjatë vitit dhe të merren veprimet e nevojshme që këto projekte të realizohen sipas planit.
6	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që bëhen barazimet e gjendjes së stoqeve në evidencat kontabël me gjendjen e tyre faktike si dhe të sigurojë se janë shtuar kontrollet për monitorimin e vazhdueshëm të tyre. Po ashtu kurdo që paraqiten diferenca të tilla të vazhdohet me hulumtimin e tyre deri të identifikohen diferenca dhe shkaktarët.
7	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që korrigjimet e efekteve nga periudhat paraprake të reflektohen edhe në kolonën e vitit paraardhës e jo vetëm në atë të vitit raportues. Gjithashtu të shpalojnë në shënimet shpjeguese të pasqyrave arsyet dhe efektet e korrigjimit për secilin zë të pasqyrave.
8	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprime adekuate për qartësimin e situatës në mes të dy kompanive dhe të siguroj dokumentacionin e nevojshëm që mbështet vlerën e parapagimeve në mënyrë që të realizoj këtë vlerë përmes marrjes së mallit apo shërbimit për to.
9	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të marrë veprimet e nevojshme për hartimin e një rregulloreje për trajtimin e provizioneve dhe borxheve të këqija të bazuar në politika të qarta dhe në harmoni me Standardet e kontabilitetit.
10	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se menaxheri i kontratës përgatit formën standarde të menaxhimit të secilit projekt me qëllim të raportimit të saktë të situacioneve të kryera dhe lehtësimit të monitorimit nga organet kompetente dhe palët e interesit.
11	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se bëhet identifikimi i nevojave për furnizime nga të gjitha njësitë kërkuese dhe njëjtat përfshihen në planin vjetor të prokurimit. Përgatitja adekuate e planeve për furnizime ndihmon në zhvillimin e procedurave adekuate dhe shtim të vlerës për para.
12	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që zyra e financave regjistrojnë transaksionet në mënyrë të drejtë duke interpretuar drejtë standardet e kontabilitetit. Po ashtu duhet të sigurojë që plani kontabël përmban të gjithë zërat që mbulojnë transaksionet e Kompanisë në përputhje me kërkesat e SNK-ve.
13	Pasqyra e të	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se çdo faturë kontrollohet me kujdesin e

	ardhurave	duhur nga zyrtarët përgjegjës para se të procedohet më tutje në kontabilitet, ndërsa për rastet e identifikuar me gabime të kërkojnë që të bëhen korrigjimet e nevojshme për t'i eliminuar efektet e gabimit.
14	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroi së janë marrë masat e nevojshme që mjetet e matjes së naftës të jenë të kalibruara dhe bëjnë matje të saktë, si dhe vëzhgimi i kamerave të jetë funksional gjatë gjithë kohës. Gjithashtu në periudha më të shpeshta të bëhen matjet e sasive në rezervar të naftës dhe të bëhet harmonizimi i shënimeve të kontabilitetit me gjendjen reale në mënyrë që të identifikohen dhe eliminohen me kohë humbjet e mundshme.
15	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ofrimi i shërbimeve bëhet vetëm për ato veprimtari të cilat janë të përcaktuara me statut dhe të marr masat e duhura për ndërprerjen e shitjes së naftës ndaj kompanisë tjetër deri sa kjo nuk është e përfshirë në fushë veprimtarinë e Trainkos-it.
16	Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	Bordi i Drejtoreve duhet të siguroj se ndryshimi i zërave të prezantuar në pasqyrën e ekuitetit referencohen dhe jepen sqarimet e nevojshme në shënimet shpjeguese për çdo ndryshim rreth tyre.
17	Shënimet shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit. Për më tepër, ato nuk duhet të miratohen pa një rishikim të hollësishëm të të gjithë zërave të pasqyrave financiare si dhe pa plotësinë dhe saktësinë e shënimeve shpjeguese.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - Trainkos sh.a, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do të ju dërgojmë të plotësuar pyetësorin për vlerësimin e subjektit të auditimit. Këtë pyetësor do të pranoni me letër përcjellëse të raportit final të auditimit.

Z. Ramush Ahmetaj

Kryesues i Bordit të Drejtorëve,

Data: 06. maj 2019, Prishtinë,

